


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Nëntor 2023

Tiranë, më 07 Dhjetor 2023: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Nëntor 2023, arriti 115,3 kundrejt muajit Dhjetor 2020.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Nëntor 2023 është 3,9 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 7,9 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Nëntor 2023, krahasuar me Tetor 2023 është -0,2 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)




Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Nëntor është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +2,52 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,37 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me +0,36 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Hotele, kafene dhe restorante” me +0,19 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” me +0,17 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me +0,16 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” me +0,14 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” me +0,10 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shërbimi arsimor” me +0,08 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shëndeti” me +0,04 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Komunikimi” me +0,02 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Transporti” kanë kontribuar me -0,25 pikë përqindje.

Për publikim 07/12/2023

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Nëntor 2022, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 7,1 %, pasuar nga grupet “Argëtim dhe kulturë” me 6,0 %, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 4,8 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 4,3 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 3,5 %, “Veshje dhe këpucë” me 2,9 %, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 2,8 %, “Shërbimi arsimor” me 2,6 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 1,9 %, “Shëndeti” me 1,0 % dhe “Komunikimi” me 0,5 %. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Transporti” shënuan ulje me 4,0 %.

Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “zarzavate përfshirë patatet” u rritën me 21,2 %, pasuar nga nëngrupet “fruta” me 9,3 %, “qumësht, djathë dhe vezë” me 8,3 %, “mish” me 7,1 %, “peshk” me 2,7 %, “sheqer, recel, mjaltë, çokollata dhe mbëlsira” me 2,6 %, etj.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Tetor 2023, çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” u ulën me 0,9 %, pasuar nga grupet “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 0,4 %, “Transporti” me 0,3 %, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 0,2 % dhe “Komunikimi” me 0,1 %. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” u rritën me 0,2 %, pasuar nga “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,1 % secili.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2020=100

Kodi	Grupet	Peshat	11-22	12-22	01-23	02-23	03-23	04-23	05-23	06-23	07-23	08-23	09-23	10-23	11-23
	Gjithsej	100	110,9	111,4	112,6	113,9	114,7	114,7	114,3	114,0	113,8	114,5	115,3	115,4	115,3
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	35,6	119,7	121,4	124,5	128,7	130,8	130,5	129,0	127,4	126,7	127,2	128,7	128,7	128,1
2	Pije alkoolike dhe duhan	4,9	107,4	107,7	108,2	108,6	109,2	109,8	110,3	110,3	110,8	110,8	111,0	111,2	111,2
3	Veshje dhe këpucë	3,6	105,2	105,6	105,5	105,3	105,3	105,4	105,8	106,2	106,7	106,6	107,5	108,1	108,2
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	19,5	104,8	104,8	105,1	105,1	105,2	105,2	105,4	105,4	105,4	106,6	106,6	106,7	106,8
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,4	107,3	107,7	108,0	108,7	109,3	110,3	110,7	111,0	111,2	111,6	112,0	112,8	112,5
6	Shëndeti	4,2	102,1	102,0	101,9	102,0	102,0	102,2	102,2	102,3	102,5	102,7	103,0	103,1	103,1
7	Transporti	6,4	119,0	115,6	116,4	113,1	112,0	110,7	109,3	109,0	109,8	112,8	114,3	114,6	114,3
8	Komunikimi	3,1	104,4	104,6	104,6	104,6	104,7	104,9	104,9	104,9	104,9	104,9	105,0	105,0	104,9
9	Argëtim dhe kulturë	2,3	105,0	105,6	106,0	106,3	108,0	108,5	109,9	111,8	110,8	110,9	112,3	112,3	111,3
10	Shërbimi arsimor	3,0	102,5	102,8	102,9	102,9	102,8	102,9	103,0	103,0	103,0	103,2	104,9	105,2	105,2
11	Hotele, kafene dhe restorante	4,5	108,7	108,7	109,4	109,5	110,0	110,4	111,4	111,8	112,5	113,0	113,0	113,3	113,3
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,5	103,1	103,0	103,3	103,6	103,9	104,6	105,0	105,2	105,4	105,6	105,9	105,9	106,0

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	11-22/11-21	12-22/12-21	01-23/01-22	02-23/02-22	03-23/03-22	04-23/04-22	05-23/05-22	06-23/06-22	07-23/07-22	08-23/08-22	09-23/09-22	10-23/10-22	11-23/11-22
	Gjithsej	7,9	7,4	7,2	7,1	5,3	4,6	4,7	4,5	4,2	4,0	4,1	3,8	3,9
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	14,7	14,2	13,3	13,5	11,0	9,6	10,0	10,3	9,0	7,8	7,9	7,4	7,1
2	Pije alkoolike dhe duhan	5,8	5,5	5,1	5,1	2,8	3,8	3,7	3,7	3,8	3,2	3,0	3,6	3,5
3	Veshje dhe këpucë	3,6	3,8	4,1	4,4	3,7	3,9	4,2	4,4	4,3	4,4	3,2	3,2	2,9
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	3,1	2,8	3,0	3,1	2,6	2,3	2,2	2,1	1,3	2,3	2,1	1,6	1,9
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	6,2	6,5	6,4	6,9	6,6	6,7	6,5	6,2	6,0	5,9	5,4	5,2	4,8
6	Shëndeti	1,3	1,1	1,0	1,0	1,1	1,4	1,4	1,2	1,1	1,3	1,4	1,1	1,0
7	Transporti	9,6	6,0	6,5	1,7	-7,5	-10,7	-12,3	-16,2	-12,4	-10,0	-7,2	-8,3	-4,0
8	Komunikimi	1,1	1,3	1,3	1,2	1,4	1,2	1,2	1,4	1,2	1,1	1,1	1,1	0,5
9	Argëtim dhe kulturë	1,0	1,3	1,8	3,4	4,7	2,4	6,9	10,3	9,5	3,9	4,9	7,6	6,0
10	Shërbimi arsimor	1,9	2,3	2,3	2,3	2,0	2,1	2,2	2,2	2,0	2,2	2,3	2,9	2,6
11	Hotele, kafene dhe restorante	6,1	5,2	5,6	5,5	4,6	4,5	5,0	4,8	5,0	5,0	4,7	4,8	4,3
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	3,6	3,3	3,6	3,2	3,2	3,6	4,0	4,0	3,7	3,7	3,1	2,9	2,8

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	11-22	12-22	01-23	02-23	03-23	04-23	05-23	06-23	07-23	08-23	09-23	10-23	11-23
	Gjithsej	-0,3	0,4	1,1	1,1	0,7	0,0	-0,3	-0,3	-0,1	0,6	0,7	0,1	-0,2
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	-0,1	1,5	2,6	3,3	1,7	-0,2	-1,2	-1,2	-0,6	0,4	1,1	0,0	-0,4
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,1	0,2	0,5	0,3	0,6	0,5	0,4	0,0	0,4	0,0	0,2	0,2	0,0
3	Veshje dhe këpucë	0,5	0,3	-0,1	-0,2	0,0	0,1	0,5	0,4	0,4	-0,1	0,8	0,5	0,2
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	-0,2	-0,1	0,3	0,0	0,0	0,0	0,2	0,0	0,0	1,1	0,0	0,1	0,1
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,2	0,3	0,3	0,7	0,6	0,9	0,3	0,3	0,2	0,3	0,4	0,6	-0,2
6	Shëndeti	0,1	-0,1	-0,1	0,1	0,0	0,3	0,0	0,0	0,2	0,2	0,3	0,0	0,0
7	Transporti	-4,8	-2,8	0,7	-2,8	-1,0	-1,1	-1,2	-0,3	0,7	2,8	1,3	0,3	-0,3
8	Komunikimi	0,5	0,2	0,0	0,0	0,1	0,2	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	0,0	-0,1
9	Argëtim dhe kulturë	0,7	0,5	0,4	0,3	1,6	0,5	1,2	1,8	-0,9	0,1	1,2	0,0	-0,9
10	Shërbimi arsimor	0,3	0,4	0,0	0,0	-0,1	0,1	0,1	0,0	0,0	0,2	1,7	0,3	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,5	0,0	0,6	0,2	0,4	0,4	0,9	0,3	0,6	0,4	0,0	0,2	0,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,1	-0,1	0,2	0,3	0,3	0,6	0,4	0,2	0,2	0,2	0,3	0,0	0,1

Metodologjia

Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2021.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbledhen çmimet.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit duke filluar nga muaji Janar 2021 llogaritet me bazën e re. Muaji Dhjetor 2020 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2020 = 100).

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.